



Nr. 841 prot.

Tiranë, më 11.05.2017

**Drejtuar: Agjencisë së Prokurimit Publik**

**Tiranë**

**Lënda:** Botim njoftimi në Buletinin e Njoftimeve Publike

Rektorati i Universitetit të Arteve shpall konkursin për 1 (një) vend të lirë pune për punonjës mësimorë si më poshtë:

### **FAKULTETI I ARTEVE TË BUKURA**

**1. Kategoria - Laborant (mësimorë): Atelieri i Skulpturës.**

Dokumentacioni që duhet të plotësojë çdo dosje e kandidatit duhet të përmbajë materialet e mëposhtme:

1. Kërkesë nga Kandidati ku të jetë përcaktuar vendi për të cilin ai konkuron;
2. Diplomë origjinale + fletë notash (shkollë e lartë në profolin përkatës, për arte, mesatare e përgjithshme mbi 8), ose fotokopje e noterizuar, e Fakultetit ku ka kryer studimet brenda ose jashtë vendit e njohur nga MASH;
3. Jetëshkrim (CV) i shoqëruar me dokumentacionin përkatës që vërteton elementët e paraqitur në të;
4. Diploma ose dëshmi në veprimtari të ndryshme profesionale;
5. Dëshmia mbi zotërimin e një gjuhe të huaj (e preferuar anglisht);
6. Të vërtetojë që ka përvojë mësimdhënie në IAL;
7. Dy referenca nga profesorë me tituj të fushës;
8. Dokumente që vërtetojnë përvojën në punë (fotokopje të librezës së punës);
9. Kopje të letërnjoftimit ose kartës së identitetit;
10. Çertifikatë familjare;
11. Të deklarojë që nuk është dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata;
12. Dëshmi e gjendjes mjeksore.







Kandidati për konkursin e Laborantit duhet të plotësojë këto kritere:

- të ketë kryer studimet në arsimin e lartë në profilin përkatës / master shkencor ose master në arte (mesatarja e përgjithshme e notave mbi 8) në Universitetin e Arteve. Në rastet kur studimet janë kryer në një shkollë të lartë në arte jashtë vendit, diploma duhet të jetë e njehsuar në MAS;
- të ketë veprimtari artistike të spikatur të artit në përgjithësi dhe të artit bashkëkohor në veçanti, shoqëruar me materiale përkatëse (vepra arti).. etj.
- të ketë përvojë në mësimdhënie në arsimin e lartë në fushën përkatëse;
- të zotërojë aftësi të mira menaxhuese, raportuese dhe komunikuese dhe të dijë të komunikojë në grup, në zbatim të Kodit të Etikës;
- të dëshmojë cilësi të mira interpretuese/mjeshtërore në procesin e zbërthimit/realizimit të veprës nëmaterial;
- të njohë një gjuhë të huaj me dëshmi, preferohet anglishtja;
- të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata.

## 1. Konkurimi për punonjës mësimor, Laborant në Atelieron e Skulpturës, zhvillohet në dy Faza:

- |                  |   |                                   |
|------------------|---|-----------------------------------|
| 1.1. Faza e parë | - | Shqyrtimi i dosjes së kandidatit; |
| 1.2. Faza e dytë | - | Mësim i hapur;                    |

### 1.1. Faza e parë:

#### 1.1.1. Dosja e Kandidatit/ëve duhet të përmbajë:

- Të dhëna të legalizuara të arsimimit të kandidatit/ëve;
- Të dhëna të legalizuara të kualifikimeve të kandidatit/ëve (nëse ka);
- Të dhëna për biografinë artistike;
- Të dhëna për përvojën në mësimdhënie të kandidatit/ëve në periudhën e pas studimeve;

### 1.2. Faza e dytë:

- Kandidati duhet t'i nënshtrohet një Mësimi të Hapur në mënyrë individuale në Laboratorin e Atelieron të Skulpturës me studentë.

Shuma e përgjithëshme e vlerësimit është 100 (njëqind) pikë.







Konkurimi do të bazohet në njohjen e ligjshmërisë në fuqi, kryesisht në Ligjin nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e AL në Republikën e Shqipërisë, Kodin e Procedurave Administrative, Statutin e Universitetit të Arteve, i ndryshuar.

Dosjet e kandidatëve do të dorëzohen në Drejtorinë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të Universitetin e Arteve nga data **15/05/2017** deri më datë **29/05/2017** ora **14.00**.

Për datën e Konkursit kandidatët të informohen pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore çdo ditë nga ora **08.00** deri **14.00**.

Prof. Kastriot ÇAUSHI  
  
REKTOR  
UNIVERSITETI I ARTEVE

